



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .02.2025

**MBLEDHJA Nr. 10,
Datë 27.02.2025, ora 09:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 27.02.2025, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 10 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 10.02.2025 dhe datë 14.02.2025.
2. Mbi implementimin e intervalit kohor 15 minuta në operimin e proceseve në tregun e balancimit.
3. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 221 datë 23.10.2024 “Mbi kërkesën e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”.
4. Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në metodologjinë e shpërndarjes së të ardhurave nga kongjestioni ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës dhe Procedurave rezervë për bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë Shqipëri.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
7. Mbi marrjen e masave administrative ndaj subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2024 të pashlyera ndaj ERE-s.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**